

PËRVOJA E STRUGËS NË PROCESET E INTEGRIMIT GJUHËSOR

Ajtene QAMILI

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqiptare, Universiteti "Shën Cirili e Metodi"

Shkup, MAQEDONI

E-mail: teni79@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Studimi i interferencës gjuhësore është problem mjaft i ndërlikuar. Nga njëra anë, ndërthurja gjuhësore në territore ku bashkëjetojnë me shekuj disa gjuhë është shumë e madhe. Nga ana tjetër, një ndikim shumë të madh në shqipen, maqedonishten, turqishten, arumanishten dhe gjuhën rome që fliten në Strugë, në rrjedhë të kohës kanë pasur latinishtja, greqishtja, turqishtja, gjuhët sllave, gjuhët neolatine e së fundi anglishtja. Këtu nuk duhet harruar edhe elementet e përbashkëta të trashëguara nga gjuha mëmë indoevropiane si dhe nënshtresa e mbishtresa gjuhësore. Problem i pakapërcyeshëm thuaja se është përcaktimi i sasisë së ndikimit të njëres gjuhë mbi tjetrën dhe anasjellas.

Në këtë kumtesë do të trajtojmë ndërndikimin e gjuhëve që janë folur dhe fliten në Strugë, si proces i integritimit gjuhësor, përkatësisht te:

1. folësit njëgjuhësh (me shqipen gjuhë amëtare);
2. folësit dygjuhësh, që dinë: a) shqip e maqedonisht, b) shqip-anglisht, c) shqip-turqisht.
3. folësit shumëgjuhësh, që flasin: a) shqip-turqisht-maqedonisht, b) shqip-maqedonisht-anglisht, c) shqip-maqedonisht-arumunisht, c) shqip-turqisht-maqedonisht-anglisht.

Fjalët kyçe: *bashkëjetesë, përvojë, ndërndikim*

gjuhësor, (shqipja, maqedonishtja, turqishtja, arumanishtja, anglishtja).

Key words: *cohabitation, experience, interconnection linguistic impact, (Albanian, Macedonian, Turkish, Vllehish, English).*

HYRJE

Të flasësh për ndërndikimet gjuhësore në vendbanime ku përdoren më shumë se dy gjuhë, do të thotë të bëhet një vështrim më thelbësor dhe më detajor mbi gjitha fushat e jetës e bashkëjetesës së popujve të cilët përfaqësojnë një tërësi. Në këtë pikpamje të pasqyrohen ndikimet e ndërsjella mes gjuhëve që ruhen dhe përdoren në Strugë e rrethinë me të vërtetë është shumë vështirë, jo për shkak të asaj se ato gjatë bashkëjetesës shekullore kanë ndikuar shumë njëra te tjetra, por për shkak të vështirësisë që të përcaktohet cila gjuhë dhe në çfarë mase ka ndikuar mbi tjetrën.

Në qarkun e Strugës sot fliten katër gjuhë: shqipja, maqedonishtja, turqishtja dhe arumanishtja, por pjesërisht përdoret edhe gjuha rome.

Zakonisht gjuha e cila ndikon më shumë mbi tjerat është gjuha e folësve me kulturë mbisunduese apo që është në pushtet dhe që i ka forcat ushtarake-politike më të fuqishme.

Elementet e huaja nga ndërndikimi janë më evidente në të folmen popullore sesa në gjuhën

standarde, për këtë arsye është e domosdoshme të studiohet e folmja dhe krijimtaria popullore (epika, lirika, balada, përrallat, kashelashet, frazeologjizmat, legjendat, fjalët e urta etj.). Për ta ilustruar këtë do japim disa shembuj që përdor populli i të gjitha kombeve në mjedisin e Strugës. Si, p.sh. frazeologjitë: (shqip) *të ka rënë luga në mjaltë* = (maqedonisht) *ti padna sekirata vo med* = (sërbisht) *pala ti sjekira u medu*; (shqip) *ma mori bukën me atë zanat* = (maqedonisht) *mi go zede lebot so toj zanaet*; (shqip) *bukë e kripë* = (maqedonisht) *leb i sol*.

Apo formulimet sintaksore: (shqip) *tash për tash jam mirë* = (maqedonisht) *sega za sega sum dobro*; (shqip) *t'ia gjej çaren* = (maqedonisht) *je mu najdam ~are*.

Poashtu edhe kalket e tipit: (shqip) *në dallim (që përkon me: në krahasim) > për dallim (za razlika), (shqip) gjen shprehje > vjen në shprehje (doa | a do izraz), ministri i arsimit > ministri për arsim (ministerot za obrazovanie), i falënderoi mysafirët > iu falenderua mysafirëve (im se zablagodari na gostite), në sajë të, falë ... > duke iu falenderuar... (blagodarenie na...), (për) një kohë të gjatë > gjatë kohë (dolgo vreme), m'i hupë nervat ose më nervozon > më shkon në nerva (ideš mi u živci); Nuk merret parasysh > nuk vjen parasysh (Ne doa | a vo predvid, Ne dolazi u obzirom), grataciell = qiellgërvishtës (por duhet = rrokaqiell) (oblakoder) etj.*

Gjuha shqipe është gjuhë e hapur dhe shumë lehtë mund të pranohet fjalët e huaja edhe për shkak të inventarit të pasur të fonemave që ka (36 fonema dhe sasi të pacaktuar alofonesh) me kombinimet e mundshme fonemore, gjegjësisht radhitja e njëpasnjëshme e 2-4 bashkëtingëlloreve (p.sh. **shndërrim, lundra, ushtrimi, nënshkruaj** etj.).

NJË VËSHTRIM RRETH PROBLEMIT

Studimi i interferencës gjuhësore është problem mjaft i ndërlikuar. Nga njëra anë, ndërthurja gjuhësore në territore ku bashkëjetojnë me shekuj disa gjuhë është shumë e madhe; nga ana tjetër, një ndikim shumë të madh në shqipen, maqedonishten, turqishten, arumanishten dhe gjuhën rome që fliten në Strugë, në rrjedhë të kohës kanë pasur latinishtja, greqishtja, turqishtja, gjuhët sllave, gjuhët neolatine e së fundi anglishtja. Këtu

nuk duhet harruar edhe elementet e përbashkëta të trashëguara nga gjuha mëmë indoevropiane si dhe nënshtresa e mbishtresa gjuhësore.

Kontaktet e drejtpërdrejta të të folmeve shqipe me të folmet maqedone, turke, arumune, sërbishten jugore etj. qysh moti kanë zgjuar interes të shumë studiues, si: F. Mikloshić, P. Skok, H. Bariq, K. Sandfeld, A.M. Selishçev, E. Çabej, Sh. Demiraj, A.V. Desnickaja, I. Popoviq, I. Ajeti, R. Ismajli, B. Vidoeski, O.J. Nasteva, J. Gjinari, R. Nesimi, Z. Osmani, L. Mulaku, H. Ymeri, A. Hamiti, A. Poloska etj.

Problem i pakapërcyeshëm thuajse është përcaktimi i sasisë së ndikimit të njerës gjuhë mbi tjetrën dhe anasjellas.

a) Maqedonishtja si gjuhë shoqërore-politike e mjedisit dhe me prestigjin që ka patur në kohën e qeverisë së ish RSFJ-së, padyshim se ka ndikuar më tepër mbi gjuhët që përdoren në këtë mjedis, veçmas në gjuhën e popullatës së paarsimuar. Pjesa më e madhe e huazimeve maqedone që përdor popullata jomaqedonase strugane, qysh moti ekzistojnë në thesarin e gjuhës së tyre amtare, por popullata e paarsimuar nuk e njeh mirë leksikon e administratës dhe të jetës shoqërore. Kjo mund të përlligjet me faktin se e tërë administrata dhe shërbimet zyrtare deri para 5 -6 vitesh, si në tërë Maqedoninë ashtu edhe në Strugë, zhvilloheshin vetëm në maqedonisht dhe popullata e haste vetëm atë terminologji. Andaj, jo rastësisht i hasim amalgamet e tipit: *Shk!ova n'sud ta podnesi m'ollbën qi ta tuzhi:s komshi:n// Aj qaku punon n'opshtë'in, amon tështë'i dë dale n'penzi*. Por ka raste kur të rijntë e arsimuar vetëm për t' u treguar se janë kullera përdorin huazime të panevojshme, si p.sh.: *Mos u bo shumë smeshno. Darka ishte bogato. Puna është zhestoko*; Sikurse edhe anglicizmat: *Unë do të asistoj; ne po inicojmë problemin; sot ishte shou në klasë; për lukun tim kujdeset...*

Sidoqoftë, huazimet maqedone kryejnë vetëm funksion të pjesshëm, kurse funksionin parësor e kryejnë fjalët e gjuhës përkatëse.

Ndikimi i shqipes mbi maqedonishten vërehet jo vetëm në përdorimin e leksemave, si: ~upe, bir, tel, pus, bosilek, kubar, kra~un, kukujavka, buza, gu{a, gua, {ara, niprka, {itnav, karpa, talas, rofja, ugi~, ~kamba, sojoi (vidovi) stranga, sugar, ker-

luk, furka, mamaliga, velenca, mo~uri{te, vrsnik, ledina, livada, dar, pijam i pijalok, kamilica, karpa, gotovo i gotvam, gurmaz i gurman, vatra, misli etj., por edhe në fushë të fonetikës psh.:

bashkëtingëlloret [j] dhe [i] nën ndikim të gegërishtes qendrore të Strugës nyjëtohen si afrikate të përparme; tek emrat e përveçëm ruhet dhanorja; përdoret forma foljore me foljen ndihmëse kam+ mbiemër prejfoljor që nuk e përdor asnjë nga të folmet qendrore dhe lindore maqedonase (imam odeno = kam shkuar); ndajfolja "posle" (pastaj) kryen funksionin e parafjalës sikurse në turqisht p.sh. posle nekolku meseci (kaç ay sonra); përdoret lidhëza "~unki" nga turqishtja "çünkü"; atributi pas emrit (iot ve~na=ve~en `ivot) etj.

Nga shqiptarët gabohen parafjalët "na" dhe "vo" nën ndikim të gjuhës së parë sepse atje ekziston forma e vetme "në", pa marrë parasysh a tregon ajo parafjalë vend të hapur apo lokal të mbyllur, p.sh. në klasë (vo u~ilnica), në arë (na niva). Dhe trajtat e shkurtëra të përemrave "ja" ~ "go" dhe "mu" ~ "n", sepse në shqipe nuk dallojnë gjini.

b). E folmja turke e Strugës më shumë ka dhënë leksema, kurse ka marrë forma. Në fakt ndryshimet që ka pësuar turqishtja e Strugës nuk janë bërë nga vetë turqit, por janë rezultat i gabimeve të joturqve kur e flasin turqishten.

Turqizmat janë shumë të pranishme në të gjitha të folmet e qarkut të Strugës, sidomos tek gjeneratat e moshuara. Nëse bëjmë krahasim se cila gjuhë ka pranuar më shumë turqizma, del se shqipja ka pranuar pak më shumë sesa maqedonishtja, për shkak të fesë së njëjtë dhe kulturës orientale. Ndërkaq, nëse krahasojmë se në cilin dialekt shqiptar kanë depërtuar më shumë turqizma del se toskët përdorin më shumë turqizma për shkak të afërsisë me qytetin, në krahasim me fshatrat geqe të Strugës, të cilat janë dukshëm më larg.

Pasojë e ndërndikimit gjuhësor janë elementet në vijim: fonemën /c/ e folmja turke e Strugës e ka marrë nga shqipja dhe maqedonishtja sepse e përdor vetëm te huazimet. Poashtu varianti i butë i fonemës /g/, gjegjesisht /ğ/ nuk përdoret fare, po në vend të saj përdoret varianti i fortë /g/ (p.sh.: sogan, agaç, dag etj); e ka humbur

harmoninë vokalike, sepse asnjëra nga gjuhët që përdoret në këtë mjedis nuk ka harmoni vokalike. Gjithashtu në strukturë e folmja turke e Strugës ka pësuar ndikim të madh nga shqipja dhe maqedonishtja, konkretisht: në vend që koha dhe mënyra foljore të ndërtohet me mbaresa, siç e ka natyrën turqishtja si gjuhë aglutinative, ajo ndërtohet me ndajfolje (apo mbiemër prejfoljor)+ folja ndihmëse "jam" me formë sikurse në shqip dhe maqedonisht "iyım (gjegjesisht, ey iyım) isın, idır, iyıs, isınıs, idiler"; forma mohore e foljes kopulative me "değil" nën ndikim të shqipes ka radhitje të kundërt, gjegjesisht iyi değil > deldir ey (s'është mirë); lidhëzat: ki (që), mënyra se si përdoret lidhëza "açan" (në vend të formës "gidecek (gideyen) zaman...", përdoret forma "açan gidecim..."); grupet e gerundit dhe pothuaj e tërë sintaksa është kalkëzim nga shqipja dhe maqedonishtja.

Një ndikim shumë karakteristik nën ndikim të turqishtes haset te folësit shqiptarë të qytetit, si pash.: *Kush ka aty?* (Orda kim var?) në vend të: *Kush është aty? Erdha me saba* (Geldim sabaylen) në vend të: *Erdha që në mëngjes.*

c). Elemente rome hasen vetëm në variantet sociale të muzikantëve struganë, si p.sh.: *as* (hesht), *aspir* (pushim, mjaft, pauzë), *ajnali* (nikoqir i mirë, bujar, i pasur), *najdo* (i humbur, i hutuar, i thjeshtë), *love* (të holla, para), *çavo* (djalo), *çavija* (vajzë), *Te puçavte?* (A të thashë?) etj.

Kurse në kahje të kundërt ndikimi është shumë i madh, përkatësisht gjuha rome e Strugës është një amalgam gjuhë rome + shqip + maqedonisht + turqisht, p.sh. *Çavo, idi gore nëna të kërkonte t'ia apish klyçat, allashkën!*

ç). Kohëve të fundit ndikimi i anglishtes mbi gjuhët evropiane po thellohet dukshëm. Elementet angleze kryesisht kanë hyrë përmes personave publikë, gjegjesisht përmes politikanëve, gazetarëve dhe njerëzve të tjerë eminentë (të arsimuar). Edhe në qarkun e Strugës këto forma kryesisht i përdorin nxënësit e shkollave të mesme, përfaqësuesit e Ojq-ve, personat publikë dhe mediat lokale.

P.sh.: për *lukun tim kujdeset...*, kjo është *nons-ens*, barnatorja punon *non-stop*, ... këndonte *llajv*, në *promocionin* e *bord-i* i organizatës, ai është *nominar*, je shu:m *fani*, *çarxhe* baterinë, hidhe në

garbiç, tejkere kët' beben, unë jam fri, ky është aim-i i projektit.

Ka edhe shumë të tjera, si: *dedlajn, netuork, supervizor, abonohem, komunitet, guajtllajn, aplikacione, flipçart, lcd, markera, pamfleta, lifleta, skripta, postera, advokaci, tajmshit, dizajn, implementim, sërç, fajl, risajkëllbin, printer, kondicioner, vois, inkajnt, interçeingjing, flesh, fastfud, input, autput, foundreising, advajs, mausin, inboks, web sajt, riplej, singinaut, ristart, okej, njusletër, fasciklla, stikera, resipt, flipçart, staf, kesh, mani-mani, billding, emergjencë, shkurtetat e fondacioneve apo organizatave përdoren vetëm në anglisht etj.*

d). Shqipja dhe arumanishtja e Strugës kanë disa afri më tepër nga gjuhët tjera që fliten në këtë mjedis, p.sh. kanë: 7 tipare të përbashkëta fonetike-fonologjike, 8-9 tipare të përbashkëta morfologjike dhe 90-100 leksema të përbashkëta.

Në fushë të fonetikës dhe fonologjisë i kanë këto tipare të përbashkëta: 1. zanorja e patheksuar /a/ në shqip kalon në /ë/, kurse në arumanisht kalon në /ă/, p.sh. shëndet = sânatate; këmishë = câmașâ. 2. Para bashkëtingëlloreve hundore /a/ latine mbyllet në të dyja gjuhët, në shqip kemi /ë/, kurse në arumanisht /ă/: këngë = cântec, këngëtar = cântător, këmbë = câmp. 3. /u/ e latinishtes ruhet në të dyja gjuhët, në krahasim më gjuhët romane të perëndimit, në të cilat ka kaluar në /o/. p.sh.: lat. exurtus > (shq.) shkurt = (arum.) scurt, lat. furca > (shq.) furkë = (arum.) furcâ, lat. fundus, (shq.) fund (arum.) fund. 4. Grupi bashkëtingëllor **ct** i latinishtes në shqip kalon në **ft** ose **jt** ose **t**, kurse në arumanisht në **pt**: lat. lucta > shq. luftë = arum. luptâ, kurse grupi **cs** në shqip del me **fsh** ose **sh**, kurse në arumanisht del me **ps** ose **s**: lat. coxa > kofsha, coapsâ. 6. Evoluim të njëjtë të disa fjalëve treqëshe latine deri në fjalë njërrokëshena, p.sh.: lat. caballus > shq. kalë, arum. cal. 7. Diftongimi i zanoreve të theksuara në të folmet geqe të Strugës dhe të aruanishtes, sidomos i zanores **ëiç**. Për të gjitha këto tipare të përbashkëta fonetike dhe fonologjike Vajgandi mendon se prej në latinisht në gjuhët romane kanë depërtuar përmes shqipes (Çabej, E. *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Prishtinë, 1976, faqe 76).

Tiparet e përbashkëta në fushë të morfologjisë janë: 1. Fjalëformimi i emrave të gjinisë femërore

duke ia shtuar prapashtesën **-onjë** ose **-ushë** = **-oaie** emrit të gjinisë mashkullore, p.sh.: ulkonjë ~ ujkonjë = ursoaie; arushë = ursoaie. 2. Pastaj formimi i ndajfoljeve prej emrave me ndihmën e prapashtesës **-isht** = **ešte** (njerëzisht = omeneste, çobanisht = ciobâniște); 3. Zëvendësimi i paskajores me mënyrën lidhore, gjegjësisht zëvendësimi i infinitivit me supinin në arumanisht, p.sh.: *është çmendur për t'u lidhur* = *nebul de legat*. 4. Prania e nyjes së pasme, gjegjësisht mbaresa e shquarsisë; 5. Topika e mbiemrit apo atributit pas emrit, p.sh.: *Uji i madh ~ Apa cea mare, Leka i madh ~ Alexandru cel mare, jeta e re*. 6. Prania e emrave të dygjinijshëm (ambigenë), p.sh.: pallat-pallate, mal-male, vend-vende, arum. loc-locuri, cuvânt-cuvinte, bilet- bilete etj.; 7. Toponimet në maqedonisht mbarojnë me **-o**, **-vo**, kurse në shqipe dhe arumanishte mbarojnë me **-a**, gjegjësisht **-va**: Tetovo-Tetova, Kumanovo-Kumanova, Kratovo-Kratova; 8. Haborja është karakteristike vetem për arumanishten e qarkut të Strugës, e cila padyshim është paraqitur në ndikim të shqipes, p.sh.: phero-phurka (e njëjtë sikur: mësoj-mësuaka ose mësoka (dial.)).

Në fushë të leksikut janë rreth 100 leksema të njëja ose të përafërta, si p.sh.: avull~abur, bajgë~baligã, baltë~baltã, bardh~bardã, buzë~buzã, çjap~tap, çukë~çiuukã, droe~droaie, dhalë~zarã, dhuratë~dar, fyell~fluiera, gardh~gard, gati~gat, gjemb~glimp, hamës~hames, kokë~coacaza, mal~mal, moshë~mos, nepërkë~nãpãrkã, përrua~paran, qafë~ceafã, rufe~rimf, sorrë~cioara, shkrep~scãparã, thërrime~fãrima, urdha~urda, vatër~vatrã.

Në Strugë kemi edhe dygjuhësi dialektore të shqipes: gegërishtja (ana verilindore e qarkut të Strugës) ndaj toskërishtes (ana jugperëndimore e qarkut të Strugës).

Nga kërkimi që kemi bërë te:

1. folësit njëgjuhësh (me shqipen gjuhë amëtare);
2. folësit dygjuhësh, që dinë: a) shqip e maqedonisht, b) shqip-anglisht, c) shqip-turqisht.
3. folësit shumëgjuhësh, që flasin: a) shqip-turqisht-maqedonisht, b) shqip-maqedonisht-anglisht, c) shqip-maqedonisht-arumanisht, ç) shqip-turqisht-maqedonisht-anglisht,

po përmbyllim se ngaqë gjuha në të cilën mendojmë i përcakton kufizimet dhe veprimet tona, nëse një person di gjuhë të dytë, por jo shumë mirë, gjithmonë bazohet në gjuhën amtare (të parë). Ndërkaq, nëse di edhe gjuhë të tretë, por jo aq mirë, shumë lehtë gjendet dhe mund të shprehet duke i kombinuar format strukturore të gjuhëve 1, 2 dhe 3.

PËRFUNDIM

Gjatë këtij hulumtimi erdhëm në përfundim se folësit shumëgjuhësh, sidomos ata që gjuhët 2 dhe 3 i kanë mësuar që në fëmijëri, janë folësit më të shkathët së pari të gjuhës së tyre amtare, kurse në krahasim me folësit dygjuhësh, gjuhën e dytë e flasin me theksin e duhur dhe e shqiptojnë më mirë dhe bëjnë më pak gabime në strukturën gjuhësore. Dhe shumë karakteristik është fakti se kur multilinguisti gjuhën e tretë e njeh më pak nga i dyti, kur e përdor gjuhën e tretë më shumë bazohet në gjuhën e dytë sesa në gjuhën amtare, që konkretisht maqedonasit kur përpiqen të flasin shqip, duke u mbështetur te anglishtja, çdo fjali e fillojnë me përemrin “unë”, apo shumësin e emrave e bëjnë me mbaresën “s”, lidhëzën “dhe” e nyjetojnë me “ë” > “dhë” etj.

Kryesisht gabimet që më shpesh i hasim te folësit dy dhe shumëgjuhësh janë radhitja e fjalëve në fjali, vend i gabuar i theksit dhe përdorim të gabuar të formave përkatëse të cilat mungojnë apo janë ndryshe në gjuhën e parë dhe të gjitha këto sepse në vetëdijen tonë mendojmë në gjuhën e parë dhe kur flasin gjuhë të dytë, të tretë apo ... ne s'bëjmë tjetër, po përkthejmë mendimin tonë në gjuhë tjetër. Kështu zakonisht lindin kallet.

Së fundi mund të themi se e folmja shqipe e Strugës edhe përkrah ndikimeve të shumta

gjuhësore në periudha të ndryshme historike dhe politike-shoqërore, përsëri ka arritur që ta ruajë formën e saj sa më të mirë, bile i është afruar edhe më shumë strukturave dhe shprehjeve të gjuhës standarde shqipe (posaçërisht te gjeneratat më të reja).

BIBLIOGRAFIA

AHMED, O. *Morfosintaksa na turskite govori od ohridsko-prespanskiot region*, (Doktorska disertacija), Skopje, Oktomvri 2004, f. 8 (dorëshkrim).

ATANASOV, P. *Romansko-Albanski jazisni vrski*, godi{en zbornik na filolozkiot fakultet “Blaze Koneski” na univerzitetot vo Skopje, (oddelel otpecatok), Skopje, 1997.

BOKSHI, B. *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984.

ÇABEJ, E. *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Prishtinë, 1976.

DEMIRAJ, Sh. *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.

Fridman, V. *Admirativot vo balkanskite jazici*, MJ, HHH, Skopje, 1980.

HAMITI, A. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005.

ISLAMAJ, Sh. *Kultura e gjuhës dhe përdorimi estetik i saj*, Tiranë, 2002.

ISMAJLI, R. *Disa fjalë shqipe në maqedonishten*, GJA, II, Prishtinë, 1971.

JASHAR-NASTEVA, O. *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, Logos-A, 1998.

KONESKI, B. *Gramatika na makedonskiot literaturen jazik (I, II)*, Skopje, 1976.

LLOSHI, Xh. *Mbështetje për gjuhën letrare*, Tiranë, 1997.

NESIMI, R. *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997.

POLOSKA, A. *Mozaiku gjuhësor*, Menora, Shkup, 2001.

SAPIR, E. *Gjuha: hyrje në studimin e ligjërimit dhe studimet mbi sistemin fonetik*, Rilindja, Prishtinë, 1980.

SHKURTAJ, Gj. *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999.

SOSYR, F. *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, (përkthyer në shqip nga Ismajli, R.), Prishtinë, 1977.